



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2629/4 prot.

Datë 14.11.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1145 /2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-81816-09-29-2023 me objekt “Blerje mobilje zyre për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”, me fond limit 2,329,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.10.2023, nga autoriteti kontraktor Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë.

**Ankimues:**

“RO-AL” SHPK me NIPT J61811001M dhe adresë: Kashar Tiranë, KM.8, Autostrada Tiranë-Durrës.

**Autoriteti Kontraktor:**

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë.  
Adresa: Rr: “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë.

**Subjekt i interesuar:** “KLAME” SHPK me NIPT K21518003F dhe adresë: Tiranë Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati i dytë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-81816-09-29-2023 me objekt “Blerje mobilje zyre për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë<sup>3</sup>”, me fond limit 2,329,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.10.2023 nga autoriteti kontraktor Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datë 13.10.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 23.10.2023, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BUNA SHPK	998,100 lekë	skualifikuar
2. Shaga SHPK	1,190,230 lekë	skualifikuar
3. JUMP ARREDIME SHPK	1,773,000 lekë	skualifikuar
4. RO-AL SHPK	1,853,000 lekë	skualifikuar
5. Klame SHPK	1.928.000 lekë	kualifikuar
6. Ardeno SHPK	2.213.000 lekë	kualifikuar

Operatori ekonomik “RO AL” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se: *“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të pikës 2, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 3, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe dokumenteve të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:*

*AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:*

*2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose autorizim distributori të autorizuar ku të vertetohet lidhja me prodhuesin, për të gjithë mallrat objekt - prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

*Për përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatori ekonomik ofertues ka paraqitur Vërtetim përktimi Nr. 1920 Rep., date 11.04.2023 të noteres Anila Q Kaçupi në të cilin shprehet se: “Përktithesja (Ina Kajtazi) është e licensuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se e*

*përktheu me përpikëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha Anglisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje noteres”*

*KVO konstaton se dokumenti “Autorizim prodhues i datës 29.04.2022” të cilin noterja deklaroi se është përkthyer dhe nënshkruar rregullisht përpara saj nuk është i nënshkruar dhe vulosur nga përkthyesja (Anila Q Kaçupi dhe asnjë përkthyes tjetër), në kundërshtim me nenin 135 të Ligjit Nr. 110/2018 PËR NOTERINË në të cilin sanksionohet: Neni 135 Vërtetimi i përkthimeve Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.*

*si rrjedhojë akti notarial i mësipërm konsiderohet i pavlefshëm në përputhje me pikën dh, të nenit 137 të Ligjit Nr. 110/2018 PËR NOTERINË. Në të cilin sanksionohet: “Veprimet dhe aktet noteriale janë të pavlefshme në të gjitha rastet kur pavlefshmëria parashikohet shprehimisht në ligj, ose është një sanksion i nevojshëm, sipas qëllimit të ligjit, veçanërisht në rastet në vijim, por pa u kufizuar në to: dh) akti ose veprimi noterial nuk përmban nënshkrimin e palëve ose nuk është nënshkruar dhe vulosur me të dyja vultat nga noteri;*

*KVO gjykon se për përmbushjen e kriterit 2.3.6 operatori ekonomik ofertues ka paraqitur një dokumentacion të pasaktë pavlefshëm në kundërshtim me kriteret e kualifikimit në të cilat përcaktohet qartë “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”*

*Është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.*

*Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3, të nenit 92, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 2, neni 82 të Vendimit të*

*Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumenteve të tenderit të miratuara, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe konkretisht 2.3.6 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit.”*

II.4. Në datën 24.10.2023, autoriteti kontraktor ka kryer Publikim Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 26.10.2023 në formë shkresore, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër protokolli 2629/2023 datë 26.10.2023, e operatorit ekonomik “Ro-Al” SHPK, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi e më konkretisht: “[...] Referuar akteve ligjore të mësipërme, rezulton se:

*Sipas ligjit, në kuptim të këtij ligji, neni 76 kriteret detyruese për skualifikim, pika 6 thotë: 6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Referuar kesaj pike ne nuk na eshte dhene mundesia te sqarojme AK pasi ai nuk na ka kerkuar sqarime rreth ketij dokumenti duke hamendesuar per falsifikim apo dokumente te rreme. Ne asnje rast dhe per asnje arsye nuk kemi qene te detyruar te falsifikojme dokumentin e siper cituar nga autoriteti kontraktor. Sqarojme se noterja ka bere vertetim perkthimi per dokumentet, te cilat kane mbajtur firmen dhe vulen e perkthyeses, pra per ato dokumente qe ishin ne gjuhe te huaj dhe duheshin perkthyer ne shqip. Per dokumentet ne rastin konkret autorizimi i prodhuesit ne na ka ardhur nga prodhuesi ne gjuhen angleze dhe shqipe e firmosur, dhe vulosur nga personi pergjegjes i asaj kompanie prodhuese GOLD SIT (OFFICE FURNITURE). Nje dokument qe sillet ne shqip nuk mund ti bashkengjitet vertetim perkthimi, por vertetimi njesia me origjinalin. Në dokumentin autorizim prodhuesi shenohen te dhenat e sakta si numer kontakti, email..etj. Fare mire institucioni mund te kontaktonte me kompanine dhe ta pyeste nese e kane leshuar nje dokument te tille ne gjuhen shqipe per te verifikuar vertetesine e tij sipas kerkeses ne DST:*

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

*1.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori të autorizuar ku të vertetohet lidhja me prodhuesin, për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Siç duket institucioni ka penalizuar duke skualifikuar RO-AL ShPK pa kontaktuar me kompaninë prodhuese.*

*Ne mendimin tone jemi ne kushtet e nje skualifiimi jo te drejte nga AK.[...]”*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 2629/2 datë 27.10.2023, lidhur me kërkesën e operatori ekonomik “Ro-Al” SHPK mbi shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Me shkresën nr. 1088/1 prot, datë 31.10.2023, protokolluar me tonën me nr.2629/3 datë 01.11.2023, me objekt: “Kthim përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor (edhe në CD) lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Referuar informacionit të mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni operatorin ekonomik ankimues në lidhje me mospranimin e ankesës, duke argumentuar si më poshtë “[...] Komisioni i shqyrtimit të ankesave pasi mori në shqyrtim Formularin e ankesës si dhe dokumentacionin shoqërues të paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues, si dhe dokumentet e paraqitura në sistemin e [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) konstaton se: Operatori ekonomik ka paraqitur në sistem të skanuar një kopje bardhë e zi në gjuhën shqipe dhe një kopje bardhë e zi në gjuhën anglisht të Autorizim prodhuesi të kompanisë prodhuese GOLD SIT (OFFICE FURNITURE). Të dyja kopjet (në gjuhën shqipe dhe gjuhën anglisht) kanë në përmbajtje nga një gjysmë vule po bardhë e zi, çka të bënë të gjykosh që nuk është një dokument origjinal. Operatori ekonomik në dokumentet bashkangjitur formularit të ankesës ka paraqitur përsëri të njëjtat kopje të pa njësuar me origjinalin të autorizim prodhuesit. Ndërkohë në gjykimin e KSHA është detyrim i operatorit ekonomik si palë e interesuar të vërtetoj vlefshmërinë e dokumentit të paraqitur prej tij për plotësimin e kriterit të vendosur nga Autoriteti në DST. Operatori ekonomik ankimues vë në dukje se "Autoriteti Kontraktor nuk ka komunikuar me kompaninë prodhuese për të vërtetuar vlefshmërinë e Autorizimit të prodhuesit", edhe pse është detyrimi i operatorit të vërtetoj vlefshmërinë e tij, qoftë edhe në fazën e ankimit të vendimit të Autoritetit Kontraktor.

*Sikurse shprehet dhe vete operatori ekonomik ankimues nenin 76 te LPP ku parashikohet se " 6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim." Sa më sipër, në rastin konkret prova që do të vërtetonte vlefshmërinë është autorizimi origjinal i prodhuesit ose kopje e njësuar nga noteri i autorizimit, duke qenë se operatori ekonomik këmbëngul që autorizimi i paraqitur prej tij është origjinal dhe jo i përkthyer, atëherë me qëllim vërtetimin e pretendimeve të tij duhet të paraqiste një kopje të njësuar të Autorizimit ose autorizimin origjinal të lëshuar nga shoqëria prodhuese GOLD SIT (OFFICE FURNITURE).*

*Ndërkohë edhe mbas skualifikimit të Autoritetit për arsye të paraqitjes së një dokumenti të*

*pasaktë, operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur pranë autoritetit një kopje të njësuar me origjinalin të vërtetimit të prodhuesit për të vërtetuar pretendimet e ngritura prej tij sipas të cilit, "Autoriteti Kontraktor ka marr një vendim jo të drejt." Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat për kualifikim. Autoritetet ose entet kontraktore vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

*Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme.*

*Ne dokumentet standarde të tenderit përcaktohet qartë: "Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim."*

*KSHA gjykon se në mbështetje të pikës 3, të nenit 80, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të cilin përcaktohet qartë se: "Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi" vendimi i marr nga KVO për ta konsideruar dokumentin jo të rregullt është i drejt.*

*Si rrjedhojë pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.*

*Autoriteti Kontraktor Vendos:*

*Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "RO-AL" SHPK për procedurën e prokurimit "Blerje mobilje zyre, për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë" me fond limit: 2,329,000 (dy milion e treqind e njëzetë e nëntë mijë) lekë pa TVSH."*

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

**Arsyeton:**

III. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Ro-Al” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose autorizim distributori të autorizuar ku të vertetohet lidhja me prodhuesin, për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik ofertues ka paraqitur Vërtetim përkthimi Nr. 1920 Rep., date 11.04.2023 të noterës Anila Q Kaçupi në të cilin shprehet se: “Përkthyesja (Ina Kajtazi) është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë e cila më deklaroi se e përktheu me përpikëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur nga gjuha Anglisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje noterës”

KVO konstaton se dokumenti “Autorizim prodhuesi i datës 29.04.2022” të cilin noterja deklaroi se është përkthyer dhe nënshkruar rregullisht përpara saj nuk është i nënshkruar dhe vulosur nga përkthyesja (Anila Q Kaçupi dhe asnjë përkthyes tjetër), në kundërshtim me nenin 135 të Ligjit Nr. 110/2018 PËR NOTERINË në të cilin sanksionohet: Neni 135 Vërtetimi i përkthimeve Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.

si rrjedhojë akti notarial i mësipërm konsiderohet I pavlefshëm në përputhje me pikën dh, të nenit 137 të Ligjit Nr. 110/2018 PËR NOTERINË. Në të cilin sanksionohet: “Veprimet dhe aktet noteriale janë të pavlefshme në të gjitha rastet kur pavlefshmëria parashikohet shprehimisht në ligj, ose është një sanksion i nevojshëm, sipas qëllimit të ligjit, veçanërisht në rastet në vijim, por pa u kufizuar në to: dh) akti ose veprimi noterial nuk përmban nënshkrimin e palëve ose nuk është nënshkruar dhe vulosur me të dyja vultat nga noteri;

KVO gjykon se për përmbushjen e kriterit 2.3.6 operatori ekonomik ofertues ka paraqitur një dokumentacion të pasaktë pavlefshëm në kundërshtim me kriteret e kualifikimit në të cilat përcaktohet qartë “Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”

Është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet



*dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3, të nenit 92, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 2, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,I ndryshuar si dhe dokumenteve të tenderit të miratuara, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe konkretisht 2.3.6 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit.”,*

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.4, “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

*2.3.4.Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose autorizim distributori te autorizuar ku te vertetohet lidhja me prodhuesin, per te gjithë mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon,e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Ro-AL” SHPK, si dhe informacionit të dhënë nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton, se operatori ekonomik “Ro-AL” SHPK ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Autorizim prodhuesi, datë 29.04.2022, lëshuar nga Goldsit Ofis Mobilyalary Sanayi Ve Ticaret A.y. për “Ro-AL”SHPK , i përkthyer dhe noterizuar, me përmbajtje si më poshtë:

*Ne: Goldsit Ofis Mobilyalary Sanayi ve Ticaret A.y. me banim në HOSAB, 9. Cadde, Nr.2A/1, to cilët janë prodhues zyrtarë të mobiljeve të zyrës dhe elementeve të ndenjësive për zyrë, konfirmojnë me këtë rast se; RO-AL SHPK 8. Km Autostrada Tirane - Durrës 1001 Tirana, Albania, është i autorizuar të ofrojë, promovojë dhe regjistrojë gamën e produkteve tona, tregtojë dhe shesë, si dhe të paraqesë oferta në tendera, të negociojë dhe të nënshkruajë kontrata me subjekte shtetërore ose private brenda territorit të Shqipërisë. Ky autorizim është i vlefshëm*

*për 5 vjet nga data e lëshimit. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi mos hezitoni të kontaktoni me ne.*

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:  
*Qëllim i këtij ligji është*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” , të ndryshuar, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer*

*shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

III.1.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet*

asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.8. Në nenin 62, pika 1/j “Kompetencat e noterit” të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, parashikohet se:

j) bën ose vërteton përkthime nga një gjuhë në një tjetër, vetë ose nëpërmjet një përkthyesi të licencuar, të pranuar nga palët ose kërkuesi;

Në nenin 135 “Vërtetimi i përkthimeve” parashikohet se:

*Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.*

Në nenin 138 “Ankimi për pavlefshmërinë e akteve ose veprimeve noteriale” parashikohet se:

*“1. Pavlefshmëria e aktit ose e veprimit noterial mund të kërkohet nga personat që kanë marrë pjesë në hartimin e tij dhe nga çdo person që heq të drejta e merr përsipër detyrime prej tyre. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale.*

*2. Në vendimin e gjykatës që deklaron të pavlefshëm një akt noterial, urdhërohet zyra përkatëse e noterisë të bëjë shënimet e duhura në origjinalin e aktit, i cili ndodhet i depozituar në këtë zyrë.”.*

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve

kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori të autorizuar ku të vërtetohet lidhja me prodhuesin, për të gjithë mallrat objekt - prokurimi. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Ro-AL” SHPK, KPP konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Autorizim prodhuesi, datë 29.04.2022, lëshuar nga Goldsit Ofis Mobilyalary Sanayi Ve Ticaret A.y. për “Ro-AL” SHPK, i përkthyer dhe noterizuar, me përmbajtje si më poshtë: *“Ne: Goldsit Ofis Mobilyalary Sanayi ve Ticaret A.y. me banim në HOSAB, 9. Cadde, Nr.2A/1, to cilët janë prodhues zyrtarë të mobiljeve të zyrës dhe elementeve të ndenjësive për zyrë, konfirmojnë me këtë rast se; RO-AL SHPK 8. Km Autostrada Tirane - Durrës 1001 Tirana, Albania, është i autorizuar të ofrojë, promovojë dhe regjistrojë gamën e produkteve tona, tregtojë dhe shesë, si dhe të paraqesë oferta në tendera, të negociojë dhe të nënshkruajë kontrata me subjekte shtetërore ose private brenda territorit të Shqipërisë. Ky autorizim është i vlefshëm për 5 vjet nga data e lëshimit. Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi mos hezitoni të kontaktoni me ne.”* Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, Autorizim prodhuesi, datë 29.04.2022, lëshuar nga Goldsit Ofis Mobilyalary Sanayi Ve Ticaret A.y. për “Ro-AL” SHPK, konstatoi se dokumentacioni është i përkthyer dhe noterizuar dhe përmban të dhëna si: *“numër repertori, datën, të dhënat e noterit (emri, mbiemri, adresa) si dhe pullë tarife e paguar. Komisioni konstaton, se çdo faqe dokumenti përmban vulën lidhëse të noterit.*

Në rastin konkret, marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të ngritur nga autoriteti kontraktor, që dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik “Ro-AL” SHPK, bien në kundërshtim me nenin 135, të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor nuk duhet të kalojë përtej kompetencave të noterit, pasi veprimet e këtij të fundit shqyrtohen nga gjykata e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor, kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal të parashikuara në nenin 82, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për më tepër, që autoriteti kontraktor mund t’i ishte drejtuar për informacion më të detajuar për vlefshmërinë e veprimeve noteriale, organeve kompetente siç është Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma e Noterisë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Ro-AL” SHPK, qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ro-AL” SHPK për procedurën e prokurimit Nr. REF-81816-09-29-2023 me objekt “Blerje mobilje zyre për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”, me fond limit 2,329,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.10.2023, nga autoriteti kontraktor Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik ” Ro-AL” SHPK duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ro-AL” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**